


TRIBUNA SINDIKALE

Qershor 2011

*Dhe dritë e diturisë
përpara do na shpjerë*



Editorial**"TRIBUNA SINDIKALE" - TRIBUNE E ÇDO SINDIKALISTI**

I dashur lexues,

Pas nje nderprerjeje relativisht te gjate, per shkak edhe te veshtiresive financiare, FSASH/SPASH po rifillojne botimin e Revistes se perbashket "Tribuna Sindikale".

Ne 41 numrat e mepareshem te "Tribunes..." eshte pasqyruar veprimtaria e gjithanshme, aktive, e perditshme e te dy sindikatave shqiptare te arsimit. Ne faqet e "Tribunes..." seksionet dhe keshillat sindikale, mesuesit sindikaliste dhe gjithë mesuesit e tjere, partneret tane sociale ne rolin e punedhenesit ne nivelin e pare dhe te dyte, cdo drejtori shkolle, ka mundesi te njihet me dokumentacionin qe institucionalizon marredheniet punedhenes-punemarres, me Kontraten Kolektive te nivelit te pare dhe vecanerisht me perpjekjet qe behen nga te dy palet ne procesin e zbatimit te dispozitave kontraktuale per pagat, sistemin e shperblimeve, sigurimet shoqerore, kohen e punes dhe te pushimit, kushtet e punes dhe lirite e te drejtat sindikale etj.

Ne Reviste kane gjetur dhe do te gjejne pasyqrim veprimtarite e sindikatave per punimin e legjislacionit te punes dhe te sistemit te arsimit,

per angazhimin e sindikatave ne procesin e reformimit dhe modernizimit te shkolles, per trajnimin sindikal dhe profesional te mesuesve, per bashkepunimin sindikate-shkolle-komunitet prinderish dhe nxenesish, per punen e vecante dhe pervojen qe kane FSASH/SPASH lidhur me nxenesit qe braktisin shkollen ose perbejne rrezik braktisjeje, per terheqjen e tyre nga puna dhe kthimin ne shkolle, etj.

Prandaj themi se "Tribuna Sindikale" eshte nje pasuri e sindikalisteve e mesuesve ne pergjithesi, eshte nje mjet ne duart e tyre qe u jep mundesi per te shprehur lirisht mendimet, per te debatuar per problematiken qe u intereson, per te kerkuar zgjidhjen e atyre ceshtjeve qe i shqetsojne, per te luftuar thyerjet e disiplines ne procesin mesimor, korrupsionin ne shkolle, etj.

Redaksia eshte e ndergjegjshme dhe synon per te bere nje kthese reale drejt nje orientimi te ri, per ta bere " Tribunen..." Tribune te vertete te sindikalisteve e mesuesve per mbrojtjen e te drejtave dhe te profesionit te tyre, per nje vleresim me te mire, ne kuptimin e gjere te fjales, te figures se tyre.

PERMBAJTJA

✓ Editorial:	2
✓ Permbajtja:	2
✓ Java e Veprimeve Globale për Arsimin 2011	3
✓ SPASH feston 20 - Vjetorin e themelimit te saj	4-5
✓ FSASH ne 20 - Vjetorin e themelimit	6-7
✓ Kontrata Kolektive e Punes, 2010 - 2014	8-14
✓ Projekt i suksesshem, ne bashkepunim me AOb, ne shkollat "Asdreni" dhe "Naim Frasherit" ne Korçe	15

Kopertina e pare:

Nga festimet e 20 - Vjetorit te SPASH dhe FSASH

Kopertina e fundit:

Nga aktivitetet ne kuadrin e Javes se Veprimeve Globale per Arsimin

**TRIBUNA SINDIKALE
Nr. 42****Qershor 2011***Botim i FSASH dhe SPASH***ADRESA:**

*Rruga "Dora D'Istria", Pallati Perballe
Fakultetit Juridik,
Tirane*

*Tel & Fax + 355 4 2 25 65 32
Celular: + 355 68 20 34 674, + 355 69
22 69 795, + 355 68 21 52 891*

*E-mail: fsash@icc-al.org
Internet: www.fsash-spash.com*

Java e Veprimeve Globale për Arsimin 2011, "Arsimimi i Grave dhe Vajzave"

Java e Veprimeve Globale për Arsimin është nje Fushate e përvitshme që zhvillohet zakonisht në fund të muajit prill ose në fillim të majit, për të bërë të mundur ndergjegjesimin dhe për t'u bërë thirrje qeverive kudo në bote që të mbajnë premtimet për realizimin e Objektivave të Kombeve të Bashkuara për Mijëvjeçarin në lidhje me Arsimimin për të Gjithë.

Sivjet Java e Veprimeve Globale u zhvillua nga data 2 deri në 8 maj.

Tema kryesore për këtë vit ishte "Arsimimi i Grave dhe Vajzave", një çështje kjo që vazhdon të përbejë një problem shqetësues për të gjitha vendet kudo në bote.

Parrulla kryesore e kesaj Fushate sivjet ishte: " Është një e drejtë, bejeni atë të mundur: Arsimim për të gjitha Gratë dhe Vajzat tani".

Arsyeja e fokusimit gjatë këtij viti tek arsimimi i grave e vajzave është se ai mbetet një problem madhor për të gjitha vendet, nderkohe që konsiderohet kyç për aftësimin e njerezve, grave e vajzave vecanerisht, që ato të marrin pjesë aktivisht dhe ta ndërtojnë vetë të ardhmen e tyre.

Statistika të besueshme tregojnë se në nivel botëror, 1 në 4 gra e vajza nuk dinë të shkruajnë e lexojnë, për shkak se, siç e dime të gjithë, ato hasin vështirësi të panumerta për të vazhduar shkollën. Nder 115 milion femije në nivel botëror që nuk kanë qenë asnjehere në shkollë, 58 milion janë vajza.

Nder 759 milion analfabete në të gjithë botën, 2/3 janë gra, shifer kjo që është përmirësuar fare pak gjatë këtyre 10 vjetëve të fundit.

Ish sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Kofi Annan, thotë:

Nuk ka një mjet tjetër më efektiv për zhvillimin e cdo vendi se sa arsimimi i grave e vajzave.



Natyrisht vendi ynë nuk radhitet ndër vendet me kaq shumë probleme të kesaj natyre, por edhe në kemi probleme të shumta lidhur me arsimimin e vajzave.

Pranohet se rreth 5 000-6 000 nxenes braktisin shkollën cdo vit, por kjo shifer mund të jetë edhe më e lartë, nderkohe që shumica e tyre janë vajza.

Synimi për arsim cilësor për të gjithë, sidomos në disa zona të thella, është ende larg për t'u arritur.

Një numer jo i vogël femijesh, ndër të cilët shumë vajza, detyrohen t'i drejtohen punës që në moshe të vogël, për shkak të shumta, kryesisht ekonomike, por edhe për shkak të mentalitetit të prindërve të tyre.

Aktivitetet e këtij viti iu adresuan pikërisht këtyre problemeve, me synimin që të gjenden dhe të përdoren të gjitha mekanizmat dhe

zgjidhet për të përmirësuar arsimimin e grave e vajzave.

Aktiviteti më i rëndësishëm i zhvilluar në këtë kuadrin, ishte një Takim Kombëtar i organizuar në Tiranë, në datën 5 maj 2011, nga dy sindikatat tona të arsimit, FSASH e SPASH, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, me pjesëmarrjen e me shumë se 85 mesuesve dhe aktivistëve të të dyja sindikatave, kryesisht gra e vajza, aktiviste e drejtues lokale të këtyre sindikatave, si edhe përfaqësues nga MASH, nga Drejtoritë Arsimore



Rajonale dhe nga institucionet arsimore vartëse.

Zevendes Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Zj. Nora Malaj, përshëndeti pjesëmarrësit, edhe në emër të Ministrit, dhe foli në lidhje me Temën kryesore të Aktiviteteve të Javës Globale të këtij viti, "Arsimimi i Grave dhe Vajzave".

Ajo vlerësoi iniciativën e sindikatave për organizimin e këtyre aktiviteteve dhe vuri në dukje angazhimin e të gjitha strukturave të MASH e të Drejtorive e Zyrave Arsimore për organizimin e aktiviteteve të kesaj Jave dhe nënvizoi se Shqipëria po bën progres të dukshëm në arsimimin e grave e vajzave, duke përmendur se 62 përqind e studentëve në shkollat e larta të vendit janë vajza, si edhe 61 përqind e 6 200 nxenesve Rome të inkuadruar në sistemin arsimor në kuadrin e projekteve të vecanta gjatë këtij viti janë vajza.

Ajo vuri në dukje angazhimin e Qeverisë shqiptare dhe të MASH për të rritur buxhetin për arsimin, duke përmendur edhe projektet që janë duke u zbatuar ose që janë në proces miratimi, në lidhje me arsimimin e grave e të vajzave.

Në vijim, folën Zevendes Kryetarja e SPASH-it, Bukuroshe Shabani, dhe Zevendes Kryetarja e FSASH-it, Fatbardha Keço,

Pas diskutimeve të shumta të pjesëmarrësve dhe nderhyrjeve të të dy kryetarëve të FSASH e SPASH, Xhafer Dobrushit e Bajram Kruja, bisedat informale vazhduan gjatë koktailit të organizuar nga të dyja sindikatat.

Një Takim interesant u zhvillua në kuadrin e aktiviteteve të kesaj Jave në Shkodër.

Me shumë se 37 pjesëmarrës; mesues, nxenes, prinder, përfaqësues të OJF-ve lokale që merren me arsimimin dhe parandalimin e punës së femijeve, moren pjesë në këtë Takim.

Moren pjesë, gjithashtu, Kryetarët e FSASH e SPASH, Xhafer Dobrushit e Bajram Kruja, si edhe përfaqësuesja e Drejtorisë Arsimore Rajonale të Shkodrës, Julinda Serreqi.

Nën kujdesin dhe angazhimin e drejtpërdrejtë të Kryetarit të Seksionit sindikal

të SPASH-it për Shkodrën, Aleks Dushi, mbështetur nga Kryetari i Seksionit sindikal të FSASH-it, Isa Reka, Takimi ishte përgatitur shumë mire dhe që me vërtetë shumë interesant.

Mesuesja Ajrina Rexha bëri një prezantim të aktiviteteve të Javës Globale në Shkodër, duke u bazuar edhe në materialin e përgatitur nga dy sindikatat e arsimit në qendër, FSASH e SPASH, si edhe në udhëzimet e EI.

Mesueset Dhurata Tyli, Vera Kadija, Frida Dashi etj, treguan histori interesante mbi vështirësitë e hasura në procesin e arsimimit të

grave e vajzave, nxenesëve ose femijeve të tyre.

Përfaqësuesja e Drejtorisë Arsimore Rajonale Shkodër, Julinda Serreqi, pasi përshëndeti pjesëmarrësit dhe sindikatat e arsimit, vuri në dukje rolin e mesuesve për arsimimin e vajzave e grave, sidomos në situatën kur me shumë se 71 përqind e mesuesve në rrethin e Shkodrës janë gra.

Ky aktivitet ishte i gërshtuar me një program të pasur artistik nga nxeneset e shkolles "Ismail Qemali", program që i ishte dedikuar pikërisht tematikës kryesore të Aktiviteteve të kesaj jave, Arsimimit të Grave e Vajzave.

Aktivitetet e shumta u organizuan në kuadrin e Javës së Veprimeve Globale për Arsimin edhe në Korçë. 46 pjesëmarrës, të gjithë mesues, nxenes, prinder e drejtues nga 6 shkollat si "Asdreni", "Naim Frasheri, Sheqeras, Pojan, "Naum Veqilharxhi" dhe "Nuci Naci" moren pjesë në Takimin e organizuar në Shkollën "Asdreni" me këtë rast.

Sekretari i Përgjithshëm i FSASH dhe Koordinator i aktiviteteve të kesaj Jave për të dyja sindikatat, Stavri Liko, foli mbi këtë ngjarje, rolin e aktiviteteve të kesaj Jave, përfshirjen e sindikatave tona të arsimit në aktivitetet globale që organizohen kudo në vendin tonë.

Mesueset Irena Vreto, Mevlude Isallari, Ylli Kreka, Juliana Dhimitri, Alma Shyle, treguan histori interesante të vajzave që janë kthyer në shkollë dhe e vazhdojnë atë rregullisht si rezultat i punës së vecantë që është bërë nga mesuesit dhe nxenesit e këtyre shkolllave, në zbatim edhe të Projektit që ato janë duke zbatuar në bashkëpunim me sindikaten e arsimit të Holandës, AOB.

Nxenesit Ervin Sinani, Jehona Qemali, Elidiona Islami, si edhe prinderit Miranda Rusi, Tatjana Frasheri, folën mbi angazhimin e tyre për uljen e braktisjes së shkolles dhe eliminimin e punës së femijeve.

Aktivitetet e tilla u organizuan në kuadrin e Javës së Veprimeve Globale për Arsimin edhe në Durrës, Vlorë, Elbasan etj.



SPASH FESTON 20-VJETORIN

Me 11 mars 2011, ne ambientet e Qendres Kulturore te Ushtrise, Sindikata e Pavarur e Arsimit te Shqiperise, SPASH, festoi 20-Vjetorin e krijimit te saj. Ne kete ceremoni te bukur festive moren pjese ish sindikaliste themelues e drejtues te SPASH ne vite, sindikaliste e drejtues te sotem te SPASH, Zevendes Ministri i Arsimit dhe

Me 28 mars u mblodh aktivi i pare i sindikates se arsimit, me pjesemarrjen e perfaqesuesve nismetare nga 16 rrethe te vendit: Nga Tirana, Imir Kambo, Bujar Cani, Agim Lame, Fitor Muça, Hysen Daja etj; nga Shkodra, Besnik Bekteshi, Qazim Lika e Xhelal Fejza; nga Durresi, Vasillaq Goga, Lluca Prifti e Bahri Dollaku; nga Elbasani, Ingrid Zaimi e Ismail Jolldashi; nga Berati, Sali Dardha; nga Kavaja, Bashkim Deliallisi;

zgjodhi Kryetar Z.Bajram Kruja dhe sekretar Z.Ismail Jolldashi nga Elbasani.

Pas Kongresit te dyte, SPASH vendosi te jete pjese e reformave te ndryshme ne te gjitha sistemin arsimor te vendit dhe te shtonte sherbimet ndaj anetaresise.

Nje kontribut te çmuar ne kete drejtim dha projekti i perbashket i AOb, (Sindikata e Arsimit e Holandes), i cili u realizua ne bashkepunim me FSASH.

SPASH ka maredhenie shume te mira bashkepunimi me SBASHK, (Sindikata e Bashkuar e Arsimit dhe Shkences e Kosoves).

Gjithashtu ne vleresojme bashkepunimin dhe ndihmen e pakursyer qe kane dhene ne funksionimin dhe konsolidimin e SPASH, BSPSH-ja dhe veçanerisht Presidenti i saj Z.Gezim Kalaja, e konkretizuar kjo edhe me nenshkrimin e Paktit te Mirekuptimit Social me Keshillin e Ministrave, me date 15 shkurt 2011.

Nuk mund te leme pa permendur kontributin e veçante qe dhane ne vitet e mepasme, ne periudha te ndryshme, drejtuesit sindikaliste Enver Ballhysa e Reihan Shkreta ne Tirane, Agim Çarçani ne Durres, Pashko Sheldia, Loro Mandi, Nirvana Leka e Rajmonda Leka ne Shkoder, Mehmet Dervishalia ne Vlore, Kastriot Kodheli e Ndue Gaspri ne Lezhe, Qazime Dardha ne Kuçove, Bejdo Çela ne Sarande, Fuat Omeri ne Delvine, Nush Smakaj ne Malesi te Madhe etj.

Me pas pershendeten te ftuarit pjesemarrres ne kete feste.

Ne emer te Ministrit te Arsimit dhe te Shkences, pershendeti Zv.Ministri, Z.Halit Shamata, i cili vleresoi kontributin e dhene nga SPASH ne gjithë procesin e zhvillimeve demokratike ne Shqiperi, ne reformat ne arsim gjate ketyre 20 viteve. Ai vleresoi veçanerisht rolin dhe kontributin e SPASH ne mbrojtjen e interesave te te gjithë te punesuaresve ne arsim, si edhe kontributin e SPASH e te Presidentit te saj, Z.Bajram Kruja, per forcimin e mardhenieve te bashkepunimit e pertneritetit midis MASH e SPASH, e konkretizuar kjo me nenshkrimin e marreveshjeve dhe Kontratave Kolektive te njepasneshme qe nga viti 1994.



Shkences Z.Halit Shamata, Presidenti i BSPSH Z.Gezim Kalaja, Presidenti i SBASHK Kosove, Z.Ali Shabani, Kryetari i FSASH Z.Xhafer Dobrush, drejtore te drejtorive te MASH dhe MPCSSH, drejtore te DAR dhe ZA te Rretheve, drejtues te Shkolles Austriake Shkoder, si dhe drejtues te sindikatave te disa profesioneve e te aparatit te BSPSH.

Zj.Bukuroshe Shabani, Zv.Presidente e SPASH, pershendeti te pranishmit dhe u uroi atyre mireseardhjen ne kete feste te 20-Vjetorit te SPASH.

Ne materialin e mbajtur ne emer te kryesise se SPASH nga Z. Nevruz Kaptelli theksohej:

Plot 20 vjet me pare, me 11 mars 1991, Ministri i Drejtesise i asaj Kohe, Z.Dashamir Kore, firmosi krijimin e Bashkimit te Sindikatave te Pavarura te Shqiperise, te pares sindikate te vertete dhe demokratike ne Shqiperi. Brenda grupimit nismetar te BSPSH, krahas minatoreve, kishte edhe mesues perfaqesues te arsimit.

nga Peshkopia, Taxhedin Shehu; nga Fieri, Llazar Lengu dhe Enver Skendaj; nga Gjirokastra, Ermir Asllani; nga Korça, Vladimir Bardhoshi; nga Peqini, Ali Kurti; nga Vlora, Ymer Yzeiri; nga Saranda, Apostol Nika; nga Pogradeci, Sami Radiçi; nga Tropoja, Halil Gjongecaj; nga Lushnja, Alfred Dhamo dhe nga Gramshi, Eqerem Dyrmyshi; te cilet krijuan Sindikaten e Pavarur te Arsimit te Shqiperise, (SPASH), kryetar i se ciles u zgjodh Z.Imir Kambo dhe nenkryetare Qazim Lika nga Shkodra dhe Vasillaq Goga nga Durresi.

Keta sindikaliste te perkushtuar e shume te tjere, qe punuan ne ato fillime te veshtira per ngritjen, organizimin dhe funksionimin e SPASH -it ne te gjithë Shqiperine, me ndihmen e pakursyer edhe te sindikatave te Arsimit te Amerikes, AFT, bene te mundur qe me

12-14 mars 1994, SPASH-i te zhvillonte Kongresin e Pare me delegate nga 24 rrethe te vendit qe perfaqesonin 32 mije mesues anetare te SPASH. Kongresi

VJETORIN E KRIJIMIT TE SAJ

Ne fjalen e tij pershendetese, Presidenti i BSPSH, Z.Gëzim Kalaja, vleresoi punen dhe arritjet e SPASH ne keto 20 vjete, duke u bere nje nga federatat kryesore te BSPSH, jo vetem persa i perkete anetaresise, por edhe per cilesine e sherbimeve ndaj anetareve.



Ish presidenti i pare i SPASH, Z.Imir Kambo, solli ne kujtesen e pjesemaresve ditet e para te formimit te kesaj sindikate, rolin dhe aktivitetin e nismetareve dhe faktorizimin e kesaj organizate te rendesishme ne jeten politike e sociale te vendit, ne fillimet e demokracice ne Shqiperi.

Presidenti i SBASHK Kosoves, Z. Ali Shabani, veç dhurates simbolike, nje harte e Kosoves, punuar me gure te tokes se saj, qe i dhuroi Presidentit te SPASH, Z.Bajram Kruja, u ndal ne bashkepunimin e ndersjellte midis dy sindikatave dhe vleresoi ndihmen e dhene nga SPASH ne njohjen e SBASHK nga organizmat sindikale nderkombetare.

Kryetari i FSASH, Z.Xhafer Dobrush, ne fjalen e tij pershendetese theksoi se baza e rritjes se forces mbrojtese te sindikates se arsimit, padyshim, qe ka gene bashkepunimi i sinqerte prej disa vitesh i te dyja sindikatave te Arsimit SPASH dhe FSASH, e konkretizuar kjo me veprimtari te ndryshme, aksione sindikaliste te perbashketa dhe botimin e Revistes se perbashket "Tribuna Sindikale".

Gjate ceremonise, Presidenti i SPASH-it, Z.Bajram Kruja, per kontributin e dhene ne levizjen sindikaliste ne arsim, iu dha nismetareve e drejtuesve te sindikates ne gender e ne rrethe Certifikata Mirenjohje.

MBLIDHET KOMITETI EKZEKUTIV DHE KESHILLI KOMBETAR I SPASH

Keto dite u mblodh Komiteti Ekzekutiv dhe Keshilli Kombetar i SPASH.

Ne fjalen e tij Presidenti i SPASH, Z. Bajram Kruja, kerkoi nga Keshilli Kombetar qe e gjithë puna dhe veprimtaria e seksioneve sindikale ne rrethe per 6-mujorin e dyte te vitit 2011 e ne vazhdim te organizohet e orientohet duke u bazuar ne PAKTIN E MIREKUPTIMIT SOCIAL, TE NENSHKRUAR ne daten 15 shkurt 2011, MIDIS KESHILLIT TE MINISTRAVE, ORGANIZATAVE TE PUNEMARRESVE DHE ORGANIZATAVE TE PUNEDHENESVE, ANETARE TE KESHILLIT KOMBETAR TE PUNES, me synim rritjen e partneritetit me strukturat drejtuese vendore e lokale deri ne nivel shkollë.

Gjithashtu, me qellim shtrirjen deri ne nivel shkollë te te gjithë aktivitetit dhe veprimtarise se strukturave drejtuese te SPASH per mbrojtjen e anetaresise nepermjet Kontrates Kolektive dhe takimeve te zhvilluara me strukturat shtetore, veprimtarine e perbashket me BSPSH, si dhe per te bere me te kontrollueshme veprimtarine mujore te keshillave sindikale te retheve, u vendos qe te premten e pare pas mbledhjes se Keshillit Kombetar te SPASH te organizohen mbledhjet e Keshillave Sindikale te SPA te rretheve dhe nje jave

dhe sindikate, ishte tema qe trajtoi Zv.Presidentja e SPASH, Zj.Bukuroshe Shabani.

3.Drejtori i Departamentit te Finances, Z. Selahedin Llukaçej, mbajti materialin e Llogarive financiare te vitit 2010, mbeshtetur ne bilancin e perfunduar nga Eksperti Kontabel i miratuar. Rreth kesaj çeshtje u diskutua nga anetaret e Keshillit Kombetar dhe ne fund u miratua bilanci financiar i vitit 2010. Lidhur me kete çeshtje Presidenti i SPASH, Z. Bajram Kruja, theksoi se me gjendjen e mire financiare te krijuar gjate vitit 2010, per vitin e ardhshem do te shohim mundesine e hartimit te nje projekt-buxheti me zera te detajuar qe ne fillim te vitit.

Gjithashtu presidenti i SPASH theksoi se gjate 6-mujorit te dyte te vitit 2011 puna e Kryesise dhe e Keshillit Kombetar do te perqendrohet ne drejtimet qe vijojne:

Ligji per Arsimin Parauniversitar, rritja e pagave, kurrikula e mesuesve te edukimit fizik, si edhe kerkesa drejtuar Sigurimeve Shoqerore per rishikimin e moshes se pensionit.

Lidhur me nenshkrimin e kontratave kolektive te nivelit te dyte, u konstatua se deri tani kane lidhur kontratat kolektive me DAR e ZA 33 rrethe dhe jane ne process 3 rrethet e fundit.



me pas ato te sindikatave ne shkolla.

Ne mbledhje u trajtuan çeshtjet e meposhtme:

1. Z. Defrim Spahiu, Zv.President i SPASH, u ndal ne zbatimin e kontratave kolektive te nivelit te dyte, te mbeshtetura nga kontrata e nivelit te pare.

2. Roli i gruas dhe i te rinjve ne arsim

Ne fund te pranishmit uruan Presidentin, Z.Bajram Kruja, me rastin e dekorimit nga Presidenti i Republikes me medaljen "PISHTAR I DEMOKRACISE".

NEVRUS KAPTELLI

*Drejtor i departamentit te
Mardhenieve me Publikun ne SPASH.*



FSASH NE 20 VJE

Me 26 prill 2011 u organizua ceremonia per festimin e 20 vjetorit te krijimit te Federates se Sindikatave te Arsimit dhe Shkences te Shqiperise. Merrnin pjese sindikaliste, nismetare e themelues te saj, veprimtare te dalluar dhe drejtues te FSASH. Ndohej edhe Ministri i Arsimit e Shkences, Prof.Dr. Myqerem Tafaj, ish ministrat e arsimit Kastriot Islami e Luan Memushi, drejtues te grupimeve sindikale dhe te sindikatave te arsimit nga Shqiperia dhe Kosova.

Veprimtarine e organizuar me kete rast e hapi zv/kryetarja e FSASH zj. Fatbardha Keco.



Kryetari i FSASH z. Xhafer Dobrush, foli per arrijtet e kesaj sindikate gjate ketyre 20 viteve. Ai theksoi se “Ndryshimi i sistemit shoqeror-politik, permbyjsja e diktatures dhe perfshirja e vendit ne proceset demokratike, fitorja e pluralizmit, kalimi nga ekonomia e centralizuar ne ekonomine e tregut, natyrshem u shoqeruan edhe me nevojen e krijimit te alternativave sindikale, te nje organizimi sindikal te pershtatshem per te mbrojtur, ne kushtet e reja, interesat e kerkesat e punemarresve, perfshire edhe punonjesit e arsimit.

Si shprehje e kesaj nevoje, u krijuan keshillat e para sindikale ne shkollat tetevjecare e te mesme, ne shume fakultete te Universitetit te Tiranës dhe te Universitetit Bujqesor. **Perfaqesuesit e zgjedhur nga keto keshilla, u mblodhen me 26 prill 1991, ne Konferencen e Pare Kombetare dhe vendosen njezeri krijimin e Federates se Sindikatave te Arsimit dhe Shkences dhe miratuan Statutin e saj.**

Thelbi i ketij organizimi te ri sindikal, ishte synimi per te krijuar nje sindikate mbi baza demokratike, vetvepruese, realiste, te pavarur nga shteti dhe partite politike, **si nje alternative konkurruese ne levizjen e re sindikale qe po lindete, jo vetem ne arsim, por edhe ne gjithe sektoret e tjere te ekonomise dhe kultures se vendit.**

Nder objektivat kryesore, qe u miratuan ne Konferencen themeluese, ishin mbrojtja e interesave ekonomike, sociale dhe profesionale te mesuesve, pedagogete dhe punonjesve shkencor; nje vleresim me i mire i figures dhe punes se tyre. Krahas kerkesave per rritjen e pagave, per javen peseditesh te punes, per kushtet e punes, per kohën e punes dhe te pushimit, per depolitizimin e shkolles, etj., u theksua nevoja per miratimin ne te ardhmen te Statusit te Mesuesit.

Ne keta 20 vjet te ekzistences, FSASH, nepermjet levizjeve sindikale dhe dialogut social, ka mundesuar arrijten dhe plotesimin e shume prej synimeve, qe i ideoi ne mblledhjen e pare themeluese dhe hap pas hapi, nepermjet veshitresive dhe pengesave te shumta, arriti te krijojte nje vizion sindikal gjithnje e me te gjere, me largpames, me bashkekohor. Si rezultat, FSASH eshte sot nje organizate sindikale e fuqishme, me rreth 20 mije anetare, me struktura te forta e te konsoliduara, e shtrire ne te gjithe vendin, nga arsimit parashkollor deri te arsimit i larte, e afte per te ndermarre e udhehequr levizje masive sindikale, si dhe per te perballuar e zhvilluar nje dialog social profesional, dinjitoz, te pergjegjshem, te vazhdueshem dhe te efektshem me punedhenesin ne te gjitha nivelet.

FSASH eshte sot nje ze i respektuar, nje faktor me rol dhe ndikim te padiskutueshem ne levizjen sindikale, jo vetem ne arsim e shkence, por edhe ne gjithe jeten sindikale brenda e jashte vendit.

Me emrin e FSASH jane te lidhura levizje te medha sindikale, manifestime, protesta dhe greva, qe nga viti 1992 e ketej, te cilat kane synuar zgjidhjen e kerkesave me kryesore te sindikalisteve. Midis tyre, eshte per t'u vecuar **Greva e Pergjithshme e Janarit 1999**, si nje levizje kulmore sindikale, si nje tregues i forces, pjekurise dhe objektivitetit te Federates.

Krahas levizjeve sindikale, FSASH ka vene ne krye te objektiveve te veta zhvillimin e dialogut social. Kontratrat Kolektive te viteve 1998, 2000, 2002, 2004, 2006 dhe 2010, te nenshkruara me MASH kane vene nga nje vit ne tjetrin, bazat e institucionalizimit te marredhenieve punedhenes-punemarres, kane rritur cilesine dhe efektivitetin e dialogut duke i shtrire bisedimet dypaleshe ne gjithe problematiken jetike te sektorit te arsimit dhe duke i bere ato nje praktike dhe metode te vazhdueshme, gje qe u ka garantuar sindikalisteve dhe gjithe punonjesve te arsimit dhe shkences mbrojtjen sociale ligjore me te

mundeshme, perfshire rritjen e vazhdueshme te pagave, permiresimin e sistemit te shperblimeve, percaktimin e kohes se punes dhe te pushimeve te paguara, perpunimin e kriterëve te punesimit dhe zgjerimin e lirive e te drejtave sindikale. Keto arrijte, ne stadin me te larte dhe me te pjekur reflektohen ne KK te Punes te dates 25 maj 2010

FSASH vleresohet sot nga organizmat nderkombetare ku eshte anetaresuar dhe nga partneret brenda vendit, si nje sindikate me standarde bashkekohore, mbasi arriti te kaperceje brenda nje dekade kuptimin e ngushte klasik dhe te njeanshem te orientimit sindikal, qe ne etapen e pare, ishte e pashmangshme. **Ne kemi hedhur hapa te ndjeshem dhe te sigurt ne lidhjen e ngushte midis kerkesave sociale ekonomike te anetareve dhe rritjes se angazhimit e marrjes se pergjegjesive konkrete nga sindikata ne procesin e reformimit e modernizimit te arsimit**, duke angazhuar mijera mesues sindikaliste, me forma nga me te ndryshmet, ne punen per arrijten e objektivit madhor kombetar per nje arsim cilesor dhe krijimin e shanseve te barabarta per te gjithë, si nje kusht baze dhe vendimtar per progresin e pergjithshem shoqeror, kulturor dhe ekonomik te vendit”.



FSASH, perfundoi z. Dobrush, eshte veper e qindra e qindra drejtuesve dhe militantëve sindikaliste, te cilet, ne kete dite feste, meritojne pergezimet, vleresimet dhe falenderimet me te perzemerta, per gjithcka kemi arritur dhe do te arrijme se bashku.

Te pranishmit i pershendeti Ministri i Arsimit dhe Shkences z. Myqerem Tafaj, Presidenti i BSPSH, z. Gezim Kalaja, Kryetari i KSSH, z. Kol Nikollaj, Kryetari i Sindikates se Bashkuar te Arsimit, Shkences dhe Kultures se Kosoves, z. Ali Shabanaj dhe zv/ Kryetari i SPASH, z. Defrim Spahiu.

Sekretari i Pergjithshem i Federates z. Stavri Liko lexoi emrat e shume sindikalisteve themelues dhe veprimtareve te dalluar, te cilet u nderuan me Çertifikata Nderi.

ETORIN E THEMELIMIT

Fjala pershendetese e Ministrit te Arsimit dhe Shkences, Prof. Dr. Myqerem Tafaj

I nderuar z. Dobrush, I nderuar z. Memushi, ish Minister i Arsimit dhe Shkences,

Te nderuar drejtues te sindikatave te tjera, Te nderuar sindikaliste, mesues, mesuese, zonja dhe zoterinj,

Ju falenderoj per ftesen qe me bete per te marre pjese ne kete ngjarje te shenuar te demokracise shqiptare – 20 vjetorin e krimit te Federates se Sindikatave te Arsimit dhe Shkences. Krijimi i kesaj sindikate eshte ne fakt nje frut i demokracise; roli i kesaj sindikate ne zhvillimin e arsimit dhe demokratizimin e shoqerise shqiptare eshte i jashtezakonshem.

Ministria e Arsimit dhe Shkences, ne keto vite, ka vleresuar dhe ka arritur te krijojte, ne kuadrin e partneritetit social, marredhenie te qendrushme dypaleshe me FSASH dhe SPASH. Keto marredhenie perfshijne diskutimin e perbashket per ceshtjet me thelbesore te hartimit te politikave arsimore, per permiresimin e kuadrin ligjor, per reformimin dhe modernizimin e gjithe sistemit te arsimit parauniversitar; tema keto qe u interesojne si mesuesve dhe sindikalisteve te arsimit ashtu edhe familjeve shqiptare, sepse ndikojne drejtperdrejt ne rritjen e cilesise se arsimimit dhe progresin e pergjithshem te shoqerise sone.

Kontrata Kolektive e Punes e nivelit te pare, qe eshte sot ne fuqi, perben nje shembull te mire te bashkepunimit serioz midis Ministrise se Arsimit dhe Shkences qe une drejtoj dhe te zgjedhurve tuaj, nje deshmi e vullnetit pozitiv te treguar nga te dy palet ne kete proces bashkepunimi. Ne kete dokument ligjor, ju e keni te lehte te shihni se sa e gjere dhe gjith perfshirese eshte problematika qe ajo zgjidh, se si jane institucionalizuar marredheniet punedhenes – punemarres, dispozitat qe garantojne punemarresit per marredheniet e punes, kohen e qendrimit ne pune, pushimet, pagat, sistemin e shperblimeve, lirite sindikale, etj.

Ne procesin e hartimit te saj si dhe ne marredheniet e perditeshme qe ne kemi, eshte vleresuar ne menyre te vecante objektivitete dhe serioziteti i Federates Suaj lidhur me kerkesat e parashtruara, forcen argumentuese ligjore dhe kembenguljen per t'i mbrojtur interesat e mesuesve. Ne kemi cmuar vecanerisht vizionin tuaj bashkekohor per te zgjidhur kerkesat social – ekonomike te

anetareve qe perfaqesoni, dhe keta jane afersisht gjysma e punonjesve te sistemit te arsimit ne Shqiperi. Thelbi i ketij bashkepunimi eshte i lidhur ngusht me angazhimin tuaj aktiv ne procesin e zhvillimit cilesor te arsimit, duke dhene kontribut ne aftesimin profesional te mesuesve, ne mbeshtetjen qe u behet mesuesve te rinj dhe jo vetem atyre, por edhe te mesuesve qe dalin ne pension.



Zonja dhe zoterinj,

Arsimi shqiptar po perjeton reforma te thella, por une desheroj t'ju falenderoj ju perzemersisht per mbeshtetjen e jashtezakonshme qe i keni dhene dhe vazhdoni t'i jepni cdo reforme ne arsimin tone. Pa ju, pa mbeshtetjen tuaj, te sindikates suaj, te sindikatave te tjera, gjithe punonjesve te arsimit, nuk do te kishte shans qe keto reforma te ishin te suksesshme.

Qeveria Berisha si ne mandatin e pare ashtu edhe ne mandatin e dyte, ka vene statusin e mesuesit ne qender te prioriteteve ne sektorin e arsimit, sepse ne e konsiderojme mesuesin faktorin kyc per cdo reforme qe ndermerret ne sistemin arsimor. Prandaj, ne jemi te vendosur qe te vazhdojme me tej me rritjen e pagave. Dyfishimi i pagave te mesuesve vetem ne 5 vjet ishte nje sukses shume i madh, qe garantoi mbeshtetjen e plote qe u dhane mesuesit reformave qe jane zhvilluar dhe po zhvillohen ne sistemin arsimor. Ky status do te vazhdoje te permiresohet ne te gjitha kendveshtrimet, do te vazhdoje rritja e pagave, do te vazhdoje mbeshtetja buxhetore

per projektet dhe programet e kualifikimit te vazhdueshem te mesuesve.

Ne shenje respekti dhe vleresimi per peshen dhe rolin qe kane mesuesit ne zhvillimin e arsimit, ne vendosem qe profesionin e mesuesise ta deklarojme si profesion te rregulluar, me synimin kryesor qe te arrijme sa me shpejt qe te jete e mundur standardet europiane ne studimet universitare

per mesuesi si dhe ne kualifikimin e vazhdueshem te mesuesve. Ky hap, sipas mendimit tim, do te jete nga me te rendesishmit qe hedhim ne konsolidimin e statusit te mesuesit, ne rritjen e rolit te mesuesve per zhvillimin e sistemit tone arsimor, i cili do te bazohet ne arrijet e sotme te shkences dhe teknologjise, per te garantuar vizionin dhe standardet europiane dhe frymen kombetare ne procesin e arsimimit te brezave te rinj.

Ne perfundim, une ju uroj edhe nje here Gezuar Festen. E konsideroj kete nje ngjarje te rendesishme te demokracise sone. Ju ftoj per nje bashkepunim te metejshem konstruktiv, si deri tani, dhe desheroj t'ju garantoj per mbeshtetjen e vazhdueshme te institucionit qe une drejtoj dhe mbeshtetjen time personale ne respekt te punes se palodhur dhe me perkushtim qe bejne mesuesit ne te gjitha qytetet dhe fshatrat e Shqiperise, ne shkollat e te gjitha niveleve te arsimit parauniversitar.

Ju falenderoj edhe nje here per ftesen dhe Gezuar Festen.

KONTRATA KOLEKTIVE E PUNES, 2010 - 2014



SINDIKATA E PAVARUR E ARSIMIT TË SHQIPËRISË

Sot, më datën 25 maj 2010, në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, në prani të palëve, nënshkruhet kjo Kontratë Kolektive Pune midis:

Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, përfaqësuar nga Ministri, z. Myqerem TAJFJA, nga njëra anë, dhe:

- Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë (FSASH), përfaqësuar nga Kryetari, z. Xhafer DOBRUSHI, dhe

- Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë (SPASH), përfaqësuar nga Kryetari z. Bajram KRUIJA, nga ana tjetër.

Neni 1

BAZALIGJORE

Kjo Kontratë Kolektive mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenet 50 dhe 51, në Konventat Ndërkombëtare të Punës, veçanërisht në Konventat nr. 87 dhe 98, në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, në nenet 159-188, në ligjin nr. 7952 date 21.6.1995 "Për arsimin parauniversitar" (i ndryshuar) dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës në tërësi dhe ato në fushën e arsimit në veçanti.

Kjo Kontratë Kolektive Pune, mbështetet gjithashtu në dispozitat e Kontratës së mëparshme Kolektive të nënshkruar me 4 Korrik 2006 dhe në kontratat e mëparshme kolektive dhe, në bazë të nenit 11 dhe 114 të Kodit të Punës, ruan e mbron arritjet e saj të deritanishme të realizuara me këto kontrata kolektive në favor të punëmarrësve, veçanërisht në fushën e marrëdhënies të punës, të pagave e shpërblimeve, të kohës së punës dhe kushteve të punës, lirive sindikale etj.

Neni 2

FUSHA E ZBATIMIT TË KONTRATËS

2.1. Kjo kontratë i shtrin efektet e saj mbi të gjithë personelin mësimor të sistemit



FEDERATA E SINDIKATAVE TË ARSIMIT TË SHQIPËRISË

Të dy palët, mbas negociemeve të zhvilluara, arritën në përfundimin që të përsëritin Kontratën e deritanishme Kolektive të Punës të datës 4 Korrik 2006 duke i bërë asaj ndryshimet, plotësimet dhe përmirësimet e nevojshme dhe duke e shtrirë periudhën e Kontratës së re nga data e nënshkrimit të saj deri më 31 Dhjetor 2014.

Në procesin e negociimit me punëdhënësin, të dy sindikatat nënshkruese provuan edhe një herë identitetin e tyre, përfshirë depozitimin e vendimeve në Gjykatën e Tiranës, që i njeht ato si persona juridike, statutet përkatëse, numrin e anëtarësisë me lista dhe me kuotizacion, si

parauniversitar, përfshirë edukatoret e kopshteve, mësuesit e ciklit të ulët dhe të lartë të shkollës 9-vjeçare, mësuesit e gjimnazeve dhe shkollave të mesme profesionale e speciale. Në këtë Kontratë mund mbështeten dhe të përfitojnë edhe të punësuarit në arsimin e lartë, kur hartojnë kontratat e nivelit të dytë, për ato dispozita që përbëjnë standarde të përgjithshme në marrëdhëniet midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, të përcaktuara në Konventat Ndërkombëtare të Punës dhe në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, ku MASH kryen funksionin e punëdhënësit të nivelit të parë, dhe punonjësit ndihmës në të gjitha nivelet.

Standardet e përgjithshme të punësimit dhe mbrojtjes së marrëdhënies të punës të përcaktuara në këtë kontratë kanë vlerë dhe efekte detyruese edhe për hartimin dhe nënshkrimin e kontratave kolektive të nivelit të dytë për arsimin jo publik.

2.2. Për arsimin parashkollor dhe parauniversitar, për punonjësit ndihmës që janë në varësi të drejtorive arsimore rajonale apo zyrave arsimore, kontratat kolektive të nivelit të dytë lidhen midis DAR/ZA dhe seksioneve sindikale të dy sindikatave nënshkruese të Kontratës Kolektive të nivelit të parë. Ndërsa, për punonjësit mësimdhënës e shkencorë dhe personelin ndihmës në arsimin e lartë kontratat kolektive të nivelit të dytë lidhen midis rektorateve e



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

dhe Marrëveshjen që kanë të dy sindikatat për t'u paraqitur si palë e vetme përpara punëdhënësit për negociimin dhe nënshkrimin e Kontratës Kolektive të Punës. Në bazë të këtyre dokumenteve, SPASH dhe FSASH rikonfirmohen nga punëdhënësi, si partnerët e vetëm në rolin e punëmarrësit për të gjithë të punësuarit në sistemin e Ministrinë se Arsimit dhe Shkencës.

Të dy palët konfirmojnë se në përfundim të bisedimeve arritën të formulojnë dhe nënshkruajnë tekstin përfundimtar të Kontratës Kolektive të Punës, me përmbajtjen që vijon:

dekanateve, nga njëra në dhe sindikatave përkatëse të çdo universiteti dhe fakulteti.

2.3. Dispozitat e Kontratës Kolektive të nivelit të parë janë të detyrueshme për zbatim nga të gjitha nivelet e tjera që legjitimohen për nënshkrimin e kontratave kolektive të nivelit të dytë, në kuptimin që këto subjekte nuk mund të përfshijnë në kontratë më pak të drejta për punëmarrësit se sa legjislacioni shqiptar dhe Kontrata Kolektive e nivelit të parë.

2.4. Palët nënshkruese në kontratat kolektive të nivelit të dytë, mbështetur në natyrën e kushteve që karakterizojnë arsimin e lartë, sidomos kërkesat e procesit të Bolonjës, dhe në arsimin parauniversitar në natyrën e kërkesave në nivel lokal, në veçorinë e kushteve të punës, mund të përfshijnë në kontratën kolektive të nivelit të dytë të drejta dhe përfitime në favor të punëmarrësve në një vëllim më të madh se ato të nivelit të parë, me kusht që këto të drejta dhe përfitime të mos bien në kundërshtim me dispozitat e shprehura në mënyrë ndaluese në legjislacionin e marrëdhënies të punës ose dispozitat e Kontratës Kolektive të nivelit të parë.

2.5. Pala e sindikatës, në momentin e lidhjes së kontratës kolektive të nivelit të dytë, duhet të paraqesë listën zyrtare të

anëtarëve të sindikatës si dhe autorizimin me shkrim nga Kryesitë e sindikatave nënshkruese të Kontratës Kolektive të nivelit të parë.

Neni 3

KOHËZGJATJAE KONTRATËS

Kjo Kontratë Kolektive do të zbatohet nga data e nënshkrimit të saj dhe deri më 31 Dhjetor 2014. Mbas këtij afati, mbështetur në nenin 173 pika 3 të Kodit të Punës, Kontrata Kolektive mund të zgjidhet me kërkesën e secilës palë, por me kusht që pala e interesuar të njoftojë tërheqjen 6 muaj më parë.

Neni 4

PUNËSIMI

4.1. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate Kolektive dhe depozitimin e saj në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, të gjithë punonjësit që aktualisht kanë një vend definitiv pune në sistemin e MASH dhe që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 4 pika 3 të kësaj kontratë, konsiderohen ligjërisht të punësuar. Ndërsa për sa i përket mbrojtjes ligjore sindikale të këtyre të drejtave të punëmarrësve para punëdhënësit, në komisionet e pajtimit apo në gjykatë, sindikatat nënshkruese të kësaj Kontrate Kolektive angazhohen dhe mbrojnë vetëm anëtarët e tyre.

Punonjësit e tjerë që nuk janë të anëtarësuar në FSASH/SPASH përfitojnë vetëm nga dispozitat e përgjithshme të kësaj Kontrate Kolektive, që zakonisht përbëjnë **standarde** dhe të drejta universale, por jo nga zgjidhjet konkrete dhe mbrojtja sindikale e këtyre zgjidhjeve, kur kanë një kërkesë apo u lind një nevojë e tillë, si në fushën e marrëdhënieve të punës, të pagave, të shpërblimeve, të sigurimeve shoqërore, pensioneve, etj., sepse të drejtën legjitime për mbrojtje ligjore sindikale për punëmarrësit që mbulohen nga kjo kontratë, e kanë vetëm sindikatat nënshkruese të Kontratës Kolektive.

4.2. Anëtarë të sindikatës konsiderohen vetëm ata mësues, pedagogë, punonjës shkencorë apo personel ndihmës, që janë deklaruar me shkrim për anëtarësimin në njërin nga sindikatat nënshkruese të kësaj kontrate, dhe që paguajnë rregullisht kuotizacionin sindikal, sipas mënyrës dhe masës që përcaktohet nga organet drejtuese të secilës sindikatë.

4.3. Kriteret bazë për punësim në arsimin parauniversitar që pranohen nga të dy palët nënshkruese të Kontratës Kolektive, mbështeten në dispozitat përkatëse të Kodit të Punës, në Konventat Ndërkombëtare të Punës, në dispozitat përkatëse të ligjit për arsimin parauniversitar, në kriteret që përmbajnë kontratat e mëparshme kolektive dhe në standardet e sotme evropiane për punësimin në arsim. Këto kriteret në mënyrë të përmbledhur janë:

a- për vendet e lira në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, punësimi bëhet me konkurs në bazë të kriterëve që përcakton Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Për efekt transparence, përfaqësuesit e SPASH/FSASH në nivel të dytë, janë të pranishëm gjatë procedurave të konkurrimit dhe vlerësimit të kandidatëve;

b- kandidati që shpallet fitues dhe punësohet për herë të parë, në vitin e parë punësohet me kontratë individuale me afat njëvjeçar. Me mbarimin e këtij afati, nëse rezultoni se i punësuar ka kryer të gjitha detyrimet që i janë caktuar nga punëdhënësi në kontratën njëvjeçare të punës, fiton të drejtën e punësimit me kontratë punë pa afat të caktuar;

c- kontrata e punës me afat njëvjeçar lidhet vetëm në fillim të vitit mësimor;

d- MASH dhe sindikatat nënshkruese të Kontratës Kolektive të nivelit të parë miratojnë tipin e kontratës së punës me afat njëvjeçar, kërkesat e së cilës janë të detyrueshme për çdo punëdhënës dhe punëmarrës në nivelin e dytë;

e- t'i përgjigjen nivelit arsimor sipas cikleve ku kërkojnë të punësohen mbështetur në kriteret dhe standardet që përcaktohen në Udhëzimin përkatës të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës.

4.4 Kushtet kryesore që ofron MASH për punësimin në sistemin parauniversitar të arsimit dhe që pranohen nga FSASH/SPASH janë:

a- **Për arsimin parashkollor dhe për ciklin e ulët të arsimit bazë të detyruar (klasa 1-5)** diplomë të shkollës së lartë në specialitetin për mësuesi.

Kriterin e mësipërm e plotësojnë edhe mësuesit që kanë mbaruar një shkollë të mesme pedagogjike ose shkollë tjetër të profilizuar për mësuesi, siç janë shkollat e mesme të muzikës, artistike, të gjuhëve të huaja dhe fiskulturës, me kusht që të kenë fituar të tri shkallët e kualifikimit. Ky nivel konsiderohet i mjaftueshëm për të ruajtur vendin e punës si i punësuar me kontratë pune pa afat.

Në këtë cikël arsimi (parashkollor + klasa 1-5), punëdhënësi, si përjashtim, për nevoja objektive të veçanta, që kushtëzohen

nga veçori dhe specifika të secilit rreth, mund të punësojë me kontratë pune me afat njëvjeçar, mësues që kanë mbaruar shkollën e mesme pedagogjike ose një shkollë tjetër të mesme të profilizuar për mësuesi, pavarësisht se nuk plotësojnë kriterin e mbrojtjes së shkallëve të kualifikimit.

b- **Për ciklin e lartë të arsimit bazë (klasa 6-9)**, diplomë universitare të fituar në një fakultet mësuesie, të barazvlefshme me nivelin 3+1.

c- **Për gjimnazet dhe shkollat e mesme profesionale:**

- Për t'u punësuar si mësues i përhershëm në këto kategori arsimi, i punësuar duhet të disponojë një diplomë universitare në degët e mësuesisë të nivelit të sotëm 3+1 ose 3+2. Përjashtim bëhet për lëndët teknologji, ekonomi dhe TIK, si dhe lëndët e tjera të specialitetit në shkollat e mesme profesionale, ku i punësuar duhet të ketë një diplomë universitare të specialitetit përkatës. Përjashtimet e tjera bëhen vetëm me udhëzim të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës në konsultim me sindikatat nënshkruese të Kontratës Kolektive të nivelit të parë.

- Kjo kategori punëmarrësish vitin e parë të punës në arsim punësohet me kontratë individuale me afat njëvjeçar.

4.5 Në raste të veçanta, për nevoja të zhvillimit normal të procesit mësimor, DAR/ZA mund të angazhojnë edhe mësues në pritmëri ose mësues pensionistë, që plotësojnë kriteret e caktuara për nivelin përkatës ku japin mësim. Paga në këto raste bëhet me orë mësimore, të cilat vlerësohen në bazë të tarifave të miratuara me VKM.

4.6 Personi që merret në punë për herë të parë pajiset nga punëdhënësi me Librezë Pune, e cila është unike për të gjithë të punësuarit, sipas modelit të përcaktuar nga organi kompetent.

4.7 Punëdhënësi nuk mund të zgjidhë kontratën e punës pa shkaqe të arsyeshme. Shkaqe të paarsyeshme konsiderohen ato që përmban neni 146, pika 1, shkronjat a, b, c, d, dhe e, të Kodit të Punës.

4.8. Zgjidhja e marrëdhënieve kontraktuale të punës nga punëdhënësi pa shkaqe të arsyeshme është e pavlefshme. Në këtë rast punëdhënësi detyrohet t'i paguajë dëmshpërblim punëmarrësit të barabartë me një vit pagë. Për të punësuarit në arsimin publik, me kërkesën e Sindikatave Qendrore nënshkruese të kësaj Kontrate ose me vendim gjykate të formës së prerë,

Vijon nga faqja 9

punëdhënësi është i detyruar ta rikthejë punëmarrësin e larguar nga puna pa shkaqe të arsyeshme, në punën e mëparshme. (Neni 146, pika 3 e KP).

4.9. Kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, për zgjidhjen e marrëdhënieve kontraktuale të punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë ndaj punëmarrësit këto afate njoftimi:

- Një muaj për të punësuarit që kanë një vit pune.
- Dy muaj për të punësuarit që kanë dy deri në pesë vjet punë
- Tre muaj, për të punësuarit që kanë me shume se 5 vjet punë.

Në mungesë të njoftimit të këtyre afateve punëdhënësi është i detyruar t'i paguajë punëmarrësit pagën mujore që i korrespondon afatit të njoftimit. (neni 143 i Kodit të Punës).

4.10 Punëmarrësi fiton shpërblim për vjetërsinë, kur kontrata është zgjidhur nga punëdhënësi dhe marrëdhëniet e punës midis tyre kanë zgjatur jo më pak se tre vjet. Në këtë rast zbatohen dispozitat e nenit 145 të Kodit të Punës. Sindikatat nënshkruese të Kontratës Kolektive mbështetin anëtarët e tyre, që këtë shpërblim ta përfitojnë duke negociuar me punëdhënësin ose duke e zgjidhur çështjen në rrugë gjyqësore.

4.11. Zgjidhja e menjëhershme e marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi ose punëmarrësi bëhet duke respektuar dispozitat e neneve 153 deri 156 të KP.

Punonjësit jo mësimorë, përfshirë të punësuarit në administratë, pastrueset, rojet etj., kur merren në punë për here të parë i nënshtrohen periudhës 3 mujore të provës, sipas nenit 142 të Kodit të Punës.

Kushtet dhe kërkesat që duhet të plotësojnë punonjësit jo mësimorë në arsimin parauniversitar në periudhën e provës, miratohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në konsultim me sindikatat nënshkruese të Kontratës Kolektive të Punës.

4.12. Kushtet e punësimit të personelit në institucionet e arsimit special dhe të institucioneve të tjera trajtohen me kontrata të nivelit të dytë.

4.13. Në vendet që krijohen të lira për punësim, përveç kriterëve të përcaktuara në nenin 4.3, kanë përparësi edhe mësuesit e cilësuar "invalidë pune" me vendim të komisionit përkatës, si dhe mësuesit që kanë humbur më parë vendin e punës për shkaqe objektive siç është reforma në arsim.

4.14. Në kuptimin e nenit 31, 33 dhe 92 të Ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 " Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë (i ndryshuar), i punësuarit në arsimin parauniversitar mund t'i përfundojë marrëdhëniet e punës me kërkesën e tij ose të punëdhënësit, me kusht që i punësuarit të këtë plotësuar kushtet që përmbajnë dispozitat e mësipërme dhe t'i këtë lindur e drejta për pension të plotë pleqërie. Në këtë rast, për të mos shkaktuar çrregullime në procesin mësimor, sidomos në marrëdhënie me nxënësit, punëdhënësit i ndalohej që t'i ndërpresë marrëdhëniet e punës të punësuarit për shkak të plotësimit të moshës së pensionit në 2 muajt e fundit të vitit shkollor.

Neni 5

NDRYSHIMI I VENDIT TË PUNËS

5.1. Sindikatat mbështetin kërkesat e anëtarëve të tyre të punësuar në arsim për ndryshimin e vendit të punës, me kusht që të përmirësohet pozita e punëmarrësit. Sindikatat, së bashku me kërkesën e të punësuarit, për ndryshimin e vendit të punës, i paraqitin punëdhënësit përkatës edhe mendimin e tyre me shkrim dhe të argumentuar, jo më vonë se data 15 maj të çdo viti.

5.2. Miratimin ose mosmiratimin e kërkesës së punëmarrësit për ndryshimin e vendit të punës, punëdhënësi është i detyruar t'ia njoftojë me shkrim punëmarrësit 30 ditë para fillimit të vitit të ri shkollor, duke parashtruar edhe argumentet përkatëse.

5.3. Ndryshimi i vendit të punës me iniciativën e punëdhënësit, bëhet vetëm për raste të veçanta dhe konkretisht:

- a- për nevoja madhore në arsim, që lidhen me kërkesa urgjente për mësues me arsim përkatës në shkolla apo zona të caktuara brenda rrethit, ku si rezultat i stafit të mësuesve pa arsim përkatës vihet në pikëpyetje dhe rrezikohet mësimdhënia;
- b- për t'u sistemuar në një shkollë tjetër, kur shkurtohet vendi i punës në shkollën e mëparshme;
- c- për thyerje të disiplinës në punë, shkelje të legjisllacionit të punës përfshirë Kontratën Kolektive dhe etikën profesionale, për mungesë profesionalizmi në ciklin përkatës;
- d- kur ndryshimi i vendit të punës bëhet për shkaqe që përcaktohen në shkronjat "a" dhe "b" të këtij neni, transferimi nuk duhet të ndikojë në keqësimin

e shëndetit të punëmarrësit, as në përkeqësimin e kushteve ekonomike, financiare dhe të jetesës;

e- për gratë me fëmijë nën moshën tre vjeç, ndryshimi i vendit të punës nuk bëhet kur rruga vajtje-ardhje zgjat më shumë se 30 minuta në këmbë, me përjashtim të rasteve kur transferimi bëhet me kërkesën e punëmarrëses ose është në favor të saj.

Si rregull, punëmarrësit i ndryshohet vendi i punës vetëm para fillimit të vitit mësimor, duke respektuar procedurat që përcakton Kodi i Punës dhe Kontrata Kolektive.

5.4. Në çdo rast, ndryshimi i vendit të punës bëhet vetëm brenda njësisë administrative në juridiksionin e drejtorisë/ zyrës arsimore përkatëse dhe duke mbajtur parasysh shkallën e kualifikimit, vjetërsinë në punë, rezultatet në punë dhe nivelin arsimor.

5.5. Urdhri për ndryshimin e vendit të punës duhet t'i jepet punëmarrësit me shkrim dhe i motivuar, 30 ditë para ekzekutimit të parashkuar.

5.6. Punëdhënësi është i detyruar të ruajë vendin e punës:

- a- për gratë shtatzëna ose me leje për mirërritjen e fëmijëve,
- b- për punonjësit që nuk gëzojnë shëndet të plotë dhe që këtë e provojnë me raport mjekësor, për aq kohë sa zgjat paaftësia e përkohshme. Këtë të drejtë e përfitojnë edhe punëmarrësit që marrin leje për kujdes familjar, me ose pa të drejtë page sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

5.7. Për anëtarët e tyre, me kërkesën e sindikatave nënshkruese, punëdhënësi është i detyruar t'i verë në dijeni ato për motivet e transferimit, për pasojat juridike, ekonomike dhe sociale që vijnë në këtë rast.

5.8 Kur ka kundërshtime nga sindikata ose i interesuari, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij njoftimi, palët duhet të bëjnë konsultime dhe të gjejnë zgjidhjet ligjore, në të kundërt secila palë rezervon të drejtën t'i drejtohet Zyrës së Pajtitimit, dhe me pas Gjykatës, vendimet e të cilës janë të detyrueshme për palët.

5.9. Punëdhënësi mund t'i ndryshojë vendin e punës punëmarrësit gjatë procesit mësimor vetëm në raste përjashtimore:

- a- Kur kemi të bëjmë me thyerje të rënda të disiplinës në punë, me shkelje të ligjit ose të kontratës kolektive.

b- Për nevoja madhore në arsim. Në këto raste duhet të merret medoemos pëlqimi i FSASH ose SPASH, kur objekt i lëvizjes në punë janë anëtarët e tyre. Në këtë rast lëvizja nuk mund të zgjatë më shumë se 1 vit mësimor pa pëlqimin e punëmarrësit.

c- Kur nuk plotësohet norma e ngarkesës mësimore për punëmarrësin.

Neni 6

KOHA E PUNËS

6.1. Në arsimin parauniversitar zbatohet java 5 ditëshe e punës, nga e hëna deri të premten. Përjashtimet bëhen me marrëveshje të veçantë midis punëdhënësit dhe punëmarrësit.

6.2. Në arsimin bazë (klasa 1-9) dhe në gjimnaze dhe arsimin e mesëm profesional, koha javore e punës përbëhet nga dy komponentë:

a) nga koha ditore gjatë së cilës punëmarrësi është në dispozicion të punëdhënësit. Në zbatim të kësaj kërkesë palët konfirmojnë se mësuesit e punësuar në arsimin bazë dhe në arsimin e mesëm paraqiten në shkollë 20 minuta para fillimit të mësimin dhe qëndrojnë në ambientet e shkollës derisa mbaron programi mësimor i turnit përkatës, por jo më shumë se 6 orë në ditë.

b) nga normat e punës mësimore javore dhe vjetore, për çdo cikël, të cilat vendosen me Udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës në konsultim me sindikatat nënshkruese të Kontratës Kolektive të Punës dhe janë aneks i kësaj Kontrate.

6.3. Ngarkesa mësimore javore për punonjësit mësimorë në arsimin parashkollor është 36 orë në javë.

6.4. Mësuesit që punojnë në ciklin e ulët dhe mësuesit që kanë klasë në kujdestari, i barasvlerësohet kjo punë me një orë mësimore.

6.5 Mësuesi që drejton veprimtaritë artistike në shkollë (një mësues për një shkollë), i ulet norma mësimore 2-4 orë në javë; ndërsa mësuesi i edukimit fizik që drejton veprimtaritë sportive (1 ose 2 mësues për një shkollë) i ulet norma mësimore nga 2-3 orë në javë.

6.6. Orët mësimore që mësuesi zhvillon mbi normën e caktuar në Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, paguhen si orë suplementare.

6.7. Me kërkesë me shkrim të DAR/ZA dhe miratimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, vetëm një mësues në shkollë për

lëndë ose grup lëndësh, mund të punojë me një ngarkesë mësimore javore më të ulët se norma deri në 3 orë në javë, ose një normë vjetore e konvertuar me këtë masë javore. Në këtë rast, orët nën normë i zbriten mësuesit nga paga me tarifën e orës suplementare.

6.8. Ngarkesa mësimore e mësuesve të cilësuar "invalidë pune" do të jetë në përputhje me vendimin e KMCAP.

6.9. Mësimdhënësit gëzojnë të drejtën për punë suplementare të pagueshme deri në 30% të ngarkesës mësimore.

6.10. Mësuesit e cilësuar "invalidë pune" nuk mund të ngarkohen me orë mësimore mbi normë.

6.11. Orët shtesë mbi normë për veprimtaritë mësimore-edukative në ditët e pushimit javor për realizimin e programit ose të aktiviteteve zyrtare që bëjnë DAR dhe ZA, do të paguhen sipas nenit 91, pika 3 e Kodit të Punës.

6.12. Koha e punës për të punësuarit e tjerë të përcaktuar në Nenin 2 të kësaj Kontrate rregullohet me VKM ose Kontratë Kolektive të nivelit të dytë.

6.13 Ministria e Arsimit dhe Shkencës merr përsipër që të vazhdojë marrjen e masave të nevojshme për normalizimin e numrit të nxënësve për çdo klasë, duke synuar që brenda 2-3 viteve të ardhshme klasat të kenë jo më shumë se 32 nxënës.

Neni 7

KOHA E PUSHIMIT

7.1. Koha e pushimit në sistemin e arsimit publik përbëhet nga pushimet javore dhe pushimet vjetore.

7.2. Pushimi javor është ditën e shtunë dhe ditën e diel.

7.3. Pushimet vjetore mbështeten në nenin 92, pika 2 të Kodit të Punës dhe në VKM nr. 220 datë 24.05.1994 "Për pushimin plotësues në sektorin e arsimit". Në bazë të këtyre dispozitave pushimet vjetore për mësimdhënësit dhe drejtuesit e tyre përbehen nga 56 ditë pune, ku përveç pushimeve verore përfshihen edhe ditët kur mësimi ndërpritet sipas programit mësimor vjetor.

Për periudhën e verës koha e pushimit nuk mund të jetë më pak se 45 ditë kalendarike dhe nuk mund të ndërpritet më shumë se një herë.

7.4. Për efekt të lejes vjetore, në kohën e punës llogaritet edhe koha e paafetësisë së përkohshme në punë.

7.5. Punëmarrësit anëtarë të sindikatave nënshkruese të kësaj Kontrate, në rast martese ose vdekjeje të bashkëshortit, të paraardhësve ose pasardhësve të tyre të drejtpërdrejtë, të motrave dhe vëllezërve, përfitojnë një pushim të paguar prej 5 ditësh.

7.6. Në rast sëmundjeje të rëndë të paraardhësve ose pasardhësve të drejtpërdrejtë, të vërtetuar me raport mjekësor, punonjësit e arsimit, anëtarë të sindikatave nënshkruese të kësaj Kontrate, përfitojnë deri në 10 ditë leje të papagueshme në muaj, por jo më shumë se 30 ditë në vit.

7.7. Me kërkesën e SPASH dhe FSASH, të zgjedhurve në kryesitë e sindikatave në shkallë rrethi dhe këshilli sindikal, u sigurohet leje e pagueshme për të marrë pjesë në veprimtaritë sindikale lokale, kombëtare e ndërkombëtare. Kërkesa i paraqitet DAR ose ZA nga kryesitë e seksioneve sindikale vendore, të paktën 3 ditë para aktivitetit.

Neni 8

SISTEMI I PAGAVE DHE SHPËRBLIMEVE

8.1. Mbështetur në Strategjinë e Arsimit Parauniversitar dhe në Programin e Qeverisë, që e konsideron arsimin si sektor parësor, të dy palët bien dakord që të ndërtojnë e zbatojnë një sistem pagash dhe shpërblimesh që mundëson një vlerësim më të mirë të figurës dhe punës së mësuesit e pedagogut dhe një motivim më të madh të tij, në bazë të angazhimit në procesin e reformimit e modernizimit të arsimit dhe të cilësisë së punës që kryen.

8.2. Punëdhënësi dhe punëmarrësi bien dakord që, në bazë të dispozitave të Kodit të Punës, të Kartës së Lirive dhe të Drejtave të Njeriut dhe të Kartës Sociale Evropiane, të garantojnë për të punësuarit pagë të barabartë për punë të barabartë dhe profesion të njëjtë, pa asnjë dallim.

8.3. Pagat e punonjësve mësimorë dhe ndihmës në sistemin e arsimit parauniversitar janë sipas strukturës së pagave të miratuara me VKM nr. 194 datë 22.04.1999 "Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar", të ndryshuar, që lidhet me rritjet dhe përmirësimet e herëpashershme të pagave të punonjësve të arsimit.

Vijon nga faqja 11

8.4. Në bazë të nenit 1 të Ligjit nr. 8487 datë 13.05.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, për ndryshimet, shtesat, plotësimet, përmirësimet dhe rritjet e mëtejshme të pagave të punonjësve të sistemit të arsimit parauniversitar, që mbrohen me këtë Kontrate Kolektive, punëdhënësi është i detyruar që në procesin e hartimit të buxhetit të çdo viti të konsultohet dhe të marrë mendimin e sindikatave nënshkruese të kësaj Kontrate Kolektive, përpara se propozimet përkatëse të dërgohen në Qeveri.

Në mënyrë të posaçme MASH duhet të zhvillojë çdo vit konsultime me FSASH/SPASH për ndërtimin e raporteve më të drejta midis pagës minimale dhe maksimale në sistemin publik të arsimit parauniversitar, si dhe të komponentit të pagës që ka të bëjë me përgatitjen dhe aftësimin profesional të mësuesve, raporte këto që vendosen brenda kuotave të buxhetit të shtetit të aprovuar për këtë nivel arsimit.

8.5. Në bazë të nenit 21 të Kartës Sociale Evropiane për të drejtën e partnerëve socialë për informim dhe me qëllim që të luftohen me efikasitet shpërdorimet dhe korrupsioni në menaxhimin e buxhetit të arsimit, sidomos për pagat, shpërblimet, shpenzimet operative dhe investimet, punëdhënësi është i detyruar që të njohë përfaqësuesit kryesorë të Sindikatave Qendrore me të gjitha të dhënat përkatëse financiare, të burimeve njerëzore, etj. Ky detyrim qëndron edhe për partnerët në nivelin e dytë.

8.6. Paga e përcaktuar në pikën 3 të këtij neni të kësaj Kontrate Kolektive është e garantuar për të gjithë të punësuarit në arsim në mënyrë definitive.

8.7. Kur mësuesit kryejnë orë mësimi mbi ngarkesën mësimore vjetore të parashikuar në këtë kontratë, orët suplementare u paguhen sipas dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi.

8.8. Mësimdhënësit që punojnë larg vendbanimit të tyre marrin një shtese në pagë sipas kriterëve që përmban VKM nr. 194 datë 22.04.1999, të cilën e përmendëm më lart. Masa e shpërblimit për mësuesit që punojnë brenda njësisë administrative të DAR/ZA të tyre dhe që kthehen brenda ditës në shtëpi bëhet sipas vendimeve përkatëse për këto pagesa.

8.9. Mbështetur në nenin 117 të Kodit të Punës, nga paga mujore e mësuesit bëhen vetëm këto zbritje:

- a- tatimi mbi të ardhurat e punonjësit;
- b- kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të caktuara me VKM;

c- kuotizacioni i anëtarësisë në sindikatë. e punës së fëmijëve.

8.10. Me autorizim me shkrim nga sindikatat nënshkruese të kësaj kontrate kolektive, mësuesit që dalin në pension përfitojnë deri në dy paga mujore shpërblim.

Neni 9

MBËSHTETJA E STRATEGJISË, REFORMIMIT DHE MODERNIZIMIT TË ARSIMIT

9.1. Sindikatat nënshkruese të kësaj kontrate kolektive, konfirmojnë se arsimit cilësor publik dhe jopublik dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës do të jenë prioritet i punës së tyre, se mbështesin dhe përfshihen aktivisht në procesin e zbatimit të Strategjisë së Arsimit, për reformimin dhe modernizimin e këtij sektori dhe se vlerësojnë programin e Qeverisë që e ka shpallur arsimin sektor prioritar, duke bashkëpunuar për përdorimin me efektivitet, kundër çdo abuzimi, shpërdorimi apo korrupsioni në dëm të buxhetit të shtetit.

9.2. Nëpërmjet seminareve, tryezave, diskutimeve në këshillat sindikale e forumet sindikale, sindikatat do të zërthejnë aspekte të veçanta të Strategjisë së Arsimit, përfshirë kurrikulat, procesin e vlerësimit, të motivimit, tekstet etj, duke e vënë theksin në njohjen dhe zbatimin e këtyre kërkesave nga mësuesit dhe anëtarët e sindikatave.

9.3. Të dy sindikatat bien dakord që të bashkërendojnë punët për arritjen e këtyre qëllimeve.

Neni 10

ANGAZHIM PËR ULJEN E NUMRIT TË FËMIJËVE QË BRAKTISIN SHKOLLËN DHE ELEMENIMIN E PUNËS SË FËMIJËVE

10.1 Të dy sindikatat e arsimit, FSASH e SPASH, angazhohen që me mundësitë e tyre dhe me mbështetje të tjera, sidomos nga Federata Ndërkombëtare e Arsimit, EI, nga sindikatat homologe, etj, të bëjnë një punë të veçantë për uljen e numrit të fëmijëve që braktisin shkollën dhe eliminimin e punës së fëmijëve.

10.2. Nëpërmjet trajnimeve të drejtuesve sindikalë dhe të anëtarëve të sindikatave si dhe nëpërmjet formave të tjera të punës konkrete në shkolla e në komunitet, ato do të synojnë për rritjen e numrit të mësuesve të angazhuar në një punë të veçantë me nxënësit që braktisin shkollën ose që janë në rrezik për ta braktisur atë, duke krijuar për ta një mjedis më tërheqës dhe më prindëror dhe duke pasur si objektiv eliminimin

10.3. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, duke e patur si një ndër prioritetet e strategjisë së saj, mbështet këtë angazhim dhe siguron gatishmërinë e administratave të shkollave për veprime të përbashkëta, duke nxitur edhe përfshirjen e organeve të nxënësve dhe prindërve që veprojnë në shkolla.

10.4. Me propozimin e kryesive të sindikatave nënshkruese të Kontratës Kolektive, DAR dhe ZA shpërblejnë nga Fondi i Veçantë mësuesit që janë të angazhuar drejtpërdrejt dhe kanë rezultate të matshme për uljen e numrit të nxënësve që braktisin shkollën dhe eliminimin e punës së fëmijëve.

Neni 11

KUSHTET E PUNËS

11.1. Shteti subvencionon shpenzimet për transportin e mësuesve dhe nxënësve të arsimit të detyruar që punojnë e mësojnë larg vendbanimit të tyre dhe që kthehen brenda ditës në vendbanim sipas vendimeve përkatëse.

11.2. Në kuadrin e marrëveshjeve midis dy palëve, të përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në konsultim me sindikatat, kriteret për kualifikimin e mësuesve.

11.3. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në konsultim me sindikatat, të përcaktojnë kriteret për përzgjedhjen, emërimin dhe kualifikimin e drejtuesve të shkollave.

11.4. MASH dhe FSASH/SPASH do të negociojnë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për të mundësuar që mësuesit që janë të anëtarësuar në njërin nga sindikatat nënshkruese të Kontratës Kolektive të përfitojnë falas ekzaminimin që kërkohet me Udhëzimin e përbashkët nr. 2, datë 25.06.2004 “Për zbatimin e VKM nr.742, dt.06.11.2003” Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.692 dt.13.12.2001 të Këshillit të Ministrave “Për masa të veçanta të mbrojtjes dhe sigurisë së shëndetit në punë”, të MSH dhe MPÇSSH. B.

Neni 12

MARRËDHËNIET ME PUSHTETIN VENDOR, KOMUNAT, BASHKITË, QARQET DHE PREFEKTURAT

12.1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe FSASH e SPASH, si partnerë, marrin përsipër që në nivel qendror dhe vendor të paraqiten si palë e përbashkët, me kërkesa dhe objektiva të përbashkëta në marrëdhëniet me organet e

pushtetit vendor, për :

a - ruajtjen dhe mirëmbajtjen e objekteve dhe mjediseve shkollore si dhe sigurimin e kushteve normale të punës për mësuesit dhe nxënësit;

b - sigurimin e transparencës për mjetet financiare që caktojnë këshillat e qarqeve, të komunave dhe bashkive për arsimin dhe për miradministrimin e këtyre mjeteve;

c - zbutjen dhe eliminimin e fenomenit të punës së fëmijëve, duke krijuar një front të përbashkët shkollë-sindikata-pushtet vendor-nxënës dhe prindër për minimizimin dhe eliminimin e numrit të nxënësve që braktisin shkollën dhe nxjerrjen nga rreziku të atyre nxënësve që përbëjnë kontingjente të mundshme për të braktisur mësimet nëpërmjet evidentimit dhe eliminimit të shkaqeve që ushqejnë dhe favorizojnë këtë fenomen.

Neni 13

LIRITË DHE TEDREJTAT SINDIKALE

13.1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës tërheq vazhdimisht mendimin e sindikatave nënshkruese të kësaj Kontrate Kolektive në procesin e hartimit të akteve ligjore e nënligjore që lidhen me reformën në arsim, me marrëdhëniet e punës, pagat, shpërblimet, kushtet e punës, etj.

13.2. Sindikatat nënshkruese të kësaj Kontrate Kolektive të pajisen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës me aktet e nxjerra prej saj, jo më vonë se 20 ditë nga momenti i shpalljes së tyre.

13.3. Për të garantuar të zgjedhurit në vendet drejtuese sindikale në kryerjen e detyrës së tyre, përfshirë kryetarin, nën/kryetarin dhe sekretarin e Këshillit Sindikal të rrethit, si dhe kryetarët e këshillave sindikale në shkolla, punëdhënësit i ndalohet t'i largojë ata nga puna, ose t'u ndryshojë vendin e punës, pa marrë më parë pëlqimin me shkrim të Kryesisë së SPASH e FSASH, përveç rasteve kur vërehen shkelje të ligjit ose të Kontratës Kolektive ose individuale te punës.

13.4. Drejtuesve te seksioneve sindikale në rrethe të secilës sindikatë nënshkruese të Kontratës Kolektive, për t'u mundësuar marrjen me veprimtari sindikale, mbështetur ne nenin 181, pika 7 e Kodit te Punës, u reduktohet ngarkesa mësimore javore, nga 5 deri në 10 orë në javë, si rregull, sipas numrit të anëtarësisë me kuotizacion.

Për seksionet sindikale në qarqe, që kanë më shumë se 600 anëtarë, i reduktohet norma mësimore javore edhe një personi të dytë me 6-8 orë në javë.

Masa konkrete e reduktimit të ngarkesës mësimore javore për çdo drejtues seksioni vendoset me marrëveshje midis dy sindikatave dhe u njoftohet drejtorive arsimore rajonale ne fillim të çdo viti mësimor. Titullarët e sindikatave qendrore mund të anulojnë në çdo kohë kërkesën e tyre për ulje të normës mësimore për ata drejtues sindikalë vendorë që nuk e justifikojnë këtë lehtësi që u bëhet.

13.5. Sindikatat nënshkruese të kësaj Kontrate Kolektive, me kërkesën e tyre duhet të njihen me të gjithë treguesit ekonomiko-financiar në nivel qendror dhe lokal.

13.6. Me kërkesën e kryesive të dy sindikatave nënshkruese të Kontratës, Drejtoria Arsimore e Qytetit Tiranë vë në dispozicion të tyre, për t'u marrë me veprimtari sindikale, nga një mësues për secilën sindikatë me ngarkesë mësimore javore të reduktuar, duke i ngarkuar këta mësues me jo më shumë se 12 orë mësimi në javë.

13.7. Në pajtim me nenin 181, pika 6 e Kodit të Punës, të zgjedhurit në organet sindikale në qendër e në rrethe, me mbarimin e mandatit, kanë të drejtë për t'u rikthyer në punë në profilin e tyre.

13.8. Dita e Mësuesit, 7 Marsi dhe Dita Ndërkombëtare e Mësuesve, "5 Tetori" do të jenë në të gjithë vendin ditë veprimtarish kushtuar këtyre festave.

13.9. Veprimtaritë sindikale zhvillohen në mjediset e shkollës, pa dëmtuar procesin mësimor. Seksionet dhe Këshillat Sindikale kanë të drejtë të shpërndajnë dhe publikojnë në mjediset e shkollës, njoftime, programe, objektiva, përfshirë Kontratën Kolektive dhe dokumente të tjera të tyre.

13.10. Kryetarëve të këshillave sindikale në shkolla që përfaqësojnë më shumë se 15 anëtarë, nuk duhet t'u caktohet klasë në kujdestari.

13.11. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, u siguron dy sindikatave qendrore, mjedise pune dhe pajisje për zhvillimin normal të veprimtarisë së tyre, ndërsa drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore të rretheve duhet t'u sigurojnë ambiente dhe pajisje pune seksioneve sindikale të FSASH dhe SPASH.

13.12. Për të lehtësuar pjesëmarrjen e kryetarëve të seksioneve sindikale të rretheve në mbledhjet e këshillave drejtuese qendrore të tyre, për 4 (katër) mbledhje në vit, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore të rretheve, mbulojnë shpenzimet e udhëtimit dhe dietat, mbi bazën e vërtetimeve me shkrim të

lëshuara nga kryesitë e sindikatave qendrore.

13.13 Drejtoritë dhe Zyrat Arsimore dhe sektorët përkatës të financës, bazuar në nenin 117/2 të Kodit të Punës dhe në nenin 8, pika 9, shkronja "c" të kësaj Kontrate zbrasin nga listëpagesat e mësuesve kuotizacionin sindikal dhe e xhirojnë në llogaritë e FSASH-SPASH në masën dhe periudhën një apo disa mujore, sipas kërkesës me shkrim të secilës Sindikatë Qendrore. Veprimi kryhet nga sektorët e financës mbasi seksionet sindikale në rrethe paraqesin pranë tyre listat e anëtarësisë, në të cilat mësuesit theksojnë shprehimisht se janë anëtarë të njëjës apo tjetrës sindikatë dhe se pranojnë që kuotizacioni sindikal t'u zbritet nga paga. Listat e paraqitura nga seksionet sindikale janë të përherëshme deri sa nënshkruesi në listë nuk ka bërë tërheqjen me shkrim. Për vërtetësinë e listave të anëtarësisë mbajnë përgjegjësi drejtuesit e seksioneve sindikale në rrethe.

13.14 Kuotizacionet e zbritura nga listë pagesat e anëtarëve të secilës sindikatë xhirohen vetëm në llogaritë që shënohen më poshtë:

- **Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë (SPASH)**, Raiffeisen Bank, nr. Llogarisë 0100805846, IBAN – AL2620211013000000100805846, ose, Banka Kombëtare Tregtare nr.1 Tiranë, nr. Llogarisë 110004685, IBAN – AL8520511014004685CL TJCLALLO, Nipt: K72413451E.

- **Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës (FSASH)**, Banka INTESA SANPAOLO, nr. Llogarisë 31420235302, IBAN - AL29208111010000031420235302, Nipt : K81916451K.

Neni 14

STATUSI DHE KODI I ETIKËS SË MËSUESIT

14.1 Të dy palët bien dakord që të intensifikojnë punën e nisur për përfundimin brenda vitit të parë të kësaj kontrate të një drafti për Statusin e Mësuesit.

14.2 Palët bien dakord që të fillojnë procedurat ligjore për miratimin e Kodit te Etikës së Mësuesit dhe të mekanizmit rregullator të tij.

Neni 15

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

15.1. Për rastet kur ka shkelje, keqinterpretim apo keqzbatim në dëm të anëtarëve të sindikatës, të një ose disa neneve

Vijon në faqen 14

Vijon nga faqja 13

të kësaj Kontrate, pala e interesuar do të ndjekë procedurën e mëposhtme për zgjidhjen e tyre:

a-Të punësuarit sipas kësaj Kontrate, kur kanë ankesa, së pari duhet ta diskutojnë dhe ta zgjidhin çështjen me titullarin e institucionit me mirëkuptim në prani të Kryetarit të sindikatës ku ai bën pjesë.

b-Nëse ankesa nuk zgjidhet me mirëkuptim sipas pikës 15/1 i interesuari ose sindikata i drejtohet me shkrim titullarit të institucionit, në të cilin ka lindur ankesa, brenda 30 ditëve nga momenti i paraqitjes së ankesës, duke parashtruar edhe arsyet e saj.

c-Në parashtrimin e ankesës duhet të përfshihen: emri i të punësuarit, paraqitja e fakteve, përcaktimi i nenit të shkelur në kontratë me referencat përkatëse, si edhe shkeljet e akteve ligjore ose nënligjore.

d-Brenda 10 ditëve, pasi merr ankesën, titullari i institucionit komunikon vendimin me shkrim për ankuesin.

e-Brenda 30 ditëve pasi merr vendimin e titullarit, ankuesi mund ta apelojë këtë vendim tek instancat më të larta. Ai bëhet me shkrim dhe duhet të shoqërohet me kopjen e vendimit të titullarit të institucionit.

f- Titullari i instancës më të lartë ose një person i autorizuar prej tij, brenda 30 ditëve komunikon përgjigjen me shkrim për të interesuarin dhe për sindikatën.

g- Kur ankesa është në nivel sindikate rrethi, procedura e mësipërme ndiqet në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, së bashku me përfaqësues të Kryesisë së FSASH dhe SPASH.

h- Nëse pas kësaj procedure, konflikti nuk gjen zgjidhje, pala e interesuar i drejtohet Gjykatës.

Neni 16

DETYRIMET DHE SANKSIONET

16.1. Palët kontraktuese janë të detyruara të përmbushin dhe respektojnë detyrimet që lindin nga Kontrata, duke respektuar kërkesat dhe duke zbatuar zgjidhjet që përmbajnë nenet 169 deri 172 të Kodit të Punës.

16.2. Në rast të thyerjes së disiplinës në punë, dëmtimit të rëndë ose të përsëritur të pasurisë së institucionit, punëmarrësve u jepen

këto masa disiplinore:

- a. Këshillim.
- b. Vërejtje.
- c. Vërejtje me paralajmërim.
- d. Zbritje në detyrë ose zbritje në një cikël më të ulët arsimit për një vit.
- e. Dëmshtëpërlim i dëmit, në masën që vendosin palët nënshkruese të kësaj kontratë ose Gjykata.
- f. Largim nga puna.

16.3. Në rast të thyerjes së rëndë të etikës në punë dhe të sjelljeve ekstremiste të padenja, nga ana e punëmarrësit mund të bëhet zgjidhja e menjëhershme e kontratës individuale të punës, bazuar në Nenin 153 të Kodit të Punës.

Neni 17

E DREJTJA E AKSIONIT SINDIKAL DHE E GREVËS

17.1. Për arritjen e qëllimeve të tyre që janë mbrojtja e interesave dhe kërkesave sociale ekonomike të anëtarëve që përfaqësojnë, në mbrojtje të zhvillimit të reformës dhe modernizimit të arsimit, të rritjes së cilësisë së procesit mësimor, sindikatat nënshkruese të Kontratës Kolektive, si partnerë të ligjshme të punëdhënësit, MASH dhe Qeverisë, do të përdorin në radhë të parë negociimin dhe dialogun social, do të bëjnë argumentimin social e ligjor të kërkesave të tyre.

17.2. Por, nëse rrugët dhe mjetet sindikale që përshkruhen në pikën 1 të këtij neni nuk do të japin rezultat, në kuptimin që nuk do të çojnë në zgjidhjen e kërkesave të parashtruara, në bazë të nenit 50, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që garanton të drejtën e grevës dhe në bazë neneve 197, 197/1, 197/2, 197/3, 197/4, 197/8, 197/9 dhe 197/10, të Kodit të Punës, të dy Sindikatat Qendrore nënshkruese të Kontratës Kolektive kanë të drejtë të përshkallëzojnë lëvizjen sindikale me anë të protestave, manifestimeve deri te greva e pjesshme ose e përgjithshme.

Neni 18

DISPOZITA TE FUNDIT

18.1. Palët, me pëlqim të dyanshëm, mund t'i bëjnë plotësime dhe ndryshime kësaj

Kontratë Kolektive gjatë periudhës që ajo është në fuqi, në përputhje me ndryshimet që mund të ndodhin në legjislacionin e vendit ose ndryshime të tjera, që lidhen me procesin e reformimit e modernizimit të arsimit.

18.2. Palët, si mundësi dhe përjashtim, mund të zgjidhin Kontratën Kolektive të Punës, por vetëm për shkaqe të arsyeshme dhe të parashikuara në ligj. Në këtë rast është i nevojshëm njoftimi paraprak me shkrim, zyrtarisht 6 muaj përpara.

Afati paralajmërues 6 muaj është i domosdoshëm edhe për këtë Kontratë Kolektive, nëse njëra nga palët, ose secila prej tyre, nuk dëshiron që ajo të jetë në fuqi edhe mbas datës 31 dhjetor 2014. Në të kundërt, në mungesë të paralajmërimit 6 muaj më parë, Kontrata vazhdon të jetë në fuqi edhe tej afatit të shënuar në nenin 3 të saj.

18.3. Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive që përbëjnë standarde, janë të detyrueshme për të gjithë punëdhënësit dhe punëmarrësit e nivelit të dytë, dhe kontratat individuale që lidhen midis punëdhënësve të çdo niveli dhe punëmarrësve në sistemin e Ministrisë Arsimit dhe Shkencës.

18.4. Kontratat Kolektive të nivelit të dytë konsiderohen ato që lidhen nga DAR/ZA me seksionet sindikale të FSASH/SPASH në qarqe e rrethe, kontratat kolektive që lidhin me partneret përkatës sindikal shkollat jopublike të sistemit të arsimit parauniversitar dhe universitar, si dhe kontratat që lidhin me partnerët e tyre sindikalë, universitetet, shkollat e larta dhe institucionet kërkimore-shkencore që janë pjesë e sistemit të Ministrisë Arsimit dhe Shkencës.



Neni 19

DEPOZITIMI

19.1. Kontrata Kolektive e Punës, hartohet në katër kopje të barazvlefshme, nga të cilat një depozitohet në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta, një në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe nga një në secilën sindikatë nënshkruese.

Për S.P.A.SH.

Bajram KRUJA
 Kryetar


Për F.S.A.SH.

Xhafer DOBRUSHI
 Kryetar


Për MINISTRINË E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Myqerem TAFALI
 Minister


Projekt i suksesshem, ne bashkepunim me AOb, ne shkollat “Asdreni” dhe “Naim Frasheri” ne Korce

Me mbeshtetjen e sindikates holandeze te arsimit, AOb, dy sindikatat tona te arsimit, FSASH dhe SPASH, ne bashkepunim me seksionet sindikale te rrethit te Korces dhe keshillat sindikale te dy shkollave “Asdreni” dhe “Naim Frasheri”,



po zbatojne me sukses projektin **“Mobilizimi i mesuesve dhe organizimi i aktiviteteve konkrete per parandalimin dhe eliminimin e largimeve nga shkolla dhe te punes se femijeve ne rrethin e Korces”**. Zbatimi i ketij projekti eshte ndjekur me vemendje te vecante nga Kryesite e FSASH e SPASH, nga Seksionet e tyre perkatese ne Korce si edhe nga keshillat sindikale ne keto shkolla.

Qe ne fillim u moren te gjitha masat e nevojshme organizative midis te cilave mund te permendim:

-U ngriten, organizuan dhe u ndihmuan per te funksionuar 4 Grupe Monitorimi ne secilen prej shkollave, “Asdreni” dhe “Naim Frasheri”, secili i perbere nga 3 mesues, 1 nxenes dhe nje prind, te cilet kane funksionuar rregullisht gjate kesaj periu dhe,

-U pergatit Plani i Punes i cili iu be i njohur dhe iu shpernda te gjitha anetareve te ketyre Grupeve,

-U percaktuan detyrat konkrete per mesuesit, nxenesit dhe aktoret e tjere te perfshire ne kete Projekt ne shkollat e jashte saj, ne komunitet.

Nje grup prej 12 mesuesish dhe 8 nxenesish e prinderish ne secilin prej ketyre dy shkollave kane mobilizuar me shume se 25 mesues e 30 nxenes e prinder ne secilen prej tyre, duke u marre konkretisht dhe individualisht me me shume se 90 nxenes qe kishin braktisur shkollen, (21 nga shkolla “Asdreni” dhe 68 nga shkolla “Naim Frasheri”), si edhe me rreth 420 nxenes ne rrezik per ta braktisur ate, (180 nxenes nga shkolla “Asdreni” dhe 240 nga shkolla “Naim Frasheri”).

Zbatimi i Projektit filloi me **mbledhjet per gatitore te organizuara ne te dy shkollat**, me pjesemarrjen e mesuesve, nxenesve e prinderve, anetare te Grupeve te Monitorimit, perfaqesues te drejtorive te shkollave dhe qeverive te nxenesve e komitetete te prinderve, perfaqesues te DAR, si edhe te drejtuesve kryesore te FSASH e SPASH, Xhafer Dobrushit e Bajram Kruja.

Puna monitoruese eshte organizuar ne menyre te perditeshme, por nderkohe jane bere analiza te herepashereshme, nepermjet takimeve te rregullta **te anetarve te Grupeve te Monitorimit**

Ne keto takime eshte diskutuar gjerisht mbi situaten ne secilen prej shkollave, si edhe per

objektivat dhe gjendjen e cdo nxenesi qe ka braktisur shkollen ose qe eshte ne rrezik per te braktisur ate, menyren e ndarjes se nxenesve, sipas grupeve dhe detyrat konkrete per secilin prej tyre, sipas vecorive qe kane te bejne me karakteristikat e vete nxenesve, qendrimin e prinderve e anetareve te tjere te familjes ndaj tyre, rolin e vete nxenesve e te organizmave te tjera etj.

Te dy kryetaret e FSASH e SPASH, Xhafer Dobrushit e Bajram Kruja, te dy drejtoret e shkollave, “Asdreni” dhe “Naim Frasheri”, Ylli Kreka dhe Ylli Shahinasi, si edhe perfaqesuesi i DAR Korce, Kostika Kapedani, kane marre pjese dhe kane dhene kontributin e tyre ne keto takime.

Takimet me disa nga prinderit e nxenesve subjekt i punes ne kuadrin e ketij Projekti kane qene me te vertete te perhereshme dhe efektive.

Ne keto takime kane marre pjese disa nga prinderit e nxenesve qe kishin braktisur shkollen ose qe ishin me shume problem nder ata qe ishin ne rrezik per ta braktisur ate, si edhe mesues, prinder e nxenes, anetare te Grupeve te Monitorimit.

Kryetaret e Grupeve te Monitorimit, Martha Xharo dhe Mailinda Tona, kane informuar



pjesemarrjes mbi punen e bere, rezultatet e arritura dhe problemet me te cilat ndeshen mesuesit e nxenesit per te realizuar objektivat e Projektit per mbajtjen e nxenesve ne shkollat dhe eliminimin e punes se femijeve.

Ata kane vene ne dukje punen efektive te mesuesve Vangjel Lena, Bruna Skrapi, Suela Duka, ne shkollen “Asdreni”, si edhe te Zv/Drejtoreshes Mevlude Isallari, si edhe te mesuesve Florenca Lubonja, Fuat Orhani, Valbona Xhafka, Niko Dreni, Valentina Nikolli, Florrie Senija, Andrea Tollkuçi etj, ne shkollen “Naim Frasheri”, si edhe te dy drejtoret e shkollave Ylli Kreka, dhe Ylli Shahinasi, te cilet kane kontribuar, jo vetem per mobilizimin e mesuesve ne shkollat e jashte saj, por edhe per punen e vecante me prinderit dhe familjet e ketyre nxenesve ne komunitet.

Me shume rendesi ishin Seminari dhe aktivitetet kulturore - artistike e sportive qe u organizuan ne te dyja keto shkolla ne fund te prillit.

46 pjesemarrës, te gjitha mesues, nxenes e prinder, anetare te grupeve te monitorimit nga te dy shkollat, si edhe drejtues sindikale nga disa shkolla te tjera te ketij rrethi, (Sheqeras, Pojan, “Naum Veqilharxhi”, dhe “Nuci Naci”), moren pjese ne Seminarin.

Seminari u zhvillua me tre seanca, te cilat paten objekte te vecanta, pjesen teorike, mbi standardet nderkombetare dhe Konventat e ILO-

mbi moshen minimale te punesimit dhe eliminimin e punes se femijeve, analiza konkrete e punes se bere, rezultateve te arritura dhe detyrat per et ardhmen, si edhe nje diskutim mbi elementet kryesore te nje Udhezuesi qe do te pergatitet mbi bazen e eksperiencës ne keto shkolla e me gjere per angazhimin dhe metodat efektive te perdorura nga sindikatat e arsimit per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve.

Mesueset Irena Vreto, Mevlude Isallari, Ylli Kreka, Ylli Shahinasi, Juliana Dhimitri, Alma Shyle, folen per situaten aktuale dhe permenden eksperiencen e shembuj konkret duke permendur emrat e atyre nxenesve qe jane rikthyer ne shkollat ose qe jane jasht rrezikut te braktisjes se shkollës, pas nje pune te vazhdueshme individuale nga ana e mesuesve me ta dhe me prinderit e tyre.

Nxenesit Ervin Sinani, Jehona Qemali, Elidiona Islami and parents Miranda Rusi, Tatjana Frasheri, folen mbi angazhimin dhe punen e tyre ne kuadrin e grupeve te monitorimit, duke dhene shembuj konkret te ndikimit te tyre tek bashkemoshataret qe kishin shfaqur probleme ne vazhdimin e shkollës.

Organizimi i te gjitha ketyre aktiviteteve eshte pare i lidhur ngushte me realizimin e objektivave te Projektit per rikthimin ne shkollat e nxenesve qe e kane braktisur ate, si edhe per nxjerrjen nga rreziku i braktisjes te atyre nxenesve qe jane ne rrezik per ta braktisur shkollen.

Keto rezultate konsiderohen si nje baze e mire per vazhdimin e kesaj pune ne te ardhmen, duke perdorur me efektivitet edhe pervojen e fituar, vecanerisht nga anetaret e Grupeve te Monitorimit dhe mesuesit e nxenesit e tjere te angazhuar ne zbatimin e ketij Projekti.

Aktivitetet e shumta kulturore, artistike e sportive u organizuan gjate dy diteve ne keto dy shkolla, me pjesemarrjen masive te nxenesve qe kishin braktisur shkollen ose ishin ne rrezik per ta braktisur ate.



Me shume se 95 nxenes moren pjese ne me shume se 10 disiplina te ndryshme artistike e sportive, si kenge, recitime, valleze, futboll, volejball etj, te ndihmuar nga me shume se 12 mesues per cdo shkollat.

Drejtorite e shkollave, mesuesit dhe vete nxenesit kane vleresuar sindikaten e arsimit te Holandes, AOb, per kete mbeshtetje dhe premtojne se do te vazhdojne punen e nisur edhe gjate diteve te pushimeve dhe sidomos me fillimin e vitit te ri shkollor.

*Stavri Liko
Kordinator i Projektit*



TRIBUNA SINDIKALE

